



01 Nr. 486/25 Dt. 07.08.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 75 paragrafi 5 të Rregullores për Transportin Rrugor në Komunën e Prizrenit nr. 001/011-171537 datë 01 dhjetor 2022, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

- Formohet dhe emërohet Komisioni për caktimin e vlerës së automjeteve të konfiskuara nga organet kompetente. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Zekë Tejeci,.....kryesues,
 - 1.2. Galip Belallari,anëtar,
 - 1.3. Laura Suka,.....anëtare,
- Detyrat e Komisionit janë: caktimin e vlerës së automjeteve të konfiskuara nga organet kompetente konformë Rregullores për Transportin Rrugor në Komunën e Prizrenit nr. 001/011-171537 datë 01 dhjetor 2022 dhe aktet të tjera ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
- Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do t'i ushtrojë në pajtim me ligjin në fuqi.
- Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Komisionit zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Komisionit,
 - Arkivës së Kryetarit.

